

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

16 Nëntor 2017

Ceremonia e Diplomimit 2017

Më 16 Nëntor 2016, në ambjentet e “Horizont Hotel”, një nga hotelet e Grupit Hotelier “Harmonia Hotels-Group”, u mbajt Ceremonia e Diplomimit e studentëve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP). Kjo ceremoni u hap me fjalën përshëndetëse të Rektores së Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Prof.Dr.Kseanela Sotirofski e cila i uroi mirëseardhjen të ftuarve të pranishëm në ceremoni dhe u drejtoi përgëzime të përzemërta diplomantëve të 2017-ës.



Ceremonia vijoi me fjalën e nderit të mbajtur nga Prefekti i Qarkut Durrës, z.Roland Nasto. Drejtori i Përgjithshëm dhe Anëtar Bordi i Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), z.Seyhan Pencabligil në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar veçanërisht dipomantëve të FASTIP, nënvizoi faktin se nga bashkëpunimi i suksesshëm ndër vite tashmë, BKT-FASTIP me rëndësi të madhe është që arsimimi dual i implementuar në FASTIP të marrë jetë edhe më gjerë në sistemin e arsimit të lartë ne vend.



Në emër të bashkëudhëtarëve të tyre përshëndetën ndër të tjera edhe si të punësuar tanimë në pozicione drejtuese pranë “Bankës Kombëtare Tregtare” dhe “Horizont Hotel” tre diplomantet më të suksesshme të departamenteve Menaxhim i Bankave dhe Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Menaxhim i Hoteleri-Turizëm . Ceremonia përfundoi menjëherë pas shpërndarjes së Diplomave ku Rektorja e UAMD, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, citoi formulën e diplomimit duke i shpallur kështu zyrtarisht të diplomuar studentët e FASTIP të cilët nën tingujt e muzikës hodhën kapelet si simbol të përfundimit të viteve të tyre të studimit pranë këtij Fakulteti.